VENDIM
Nr. 131, datë 31.10.2015

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË ANKANDIT TË ZYRËS SË KOORDINUAR TË ANKANDEVE PËR EVROPËN JUGLINDORE (SEE CAO), VERSIONI 1.2

Në mbështetje të neneve 16 dhe 65 pika 1 të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të nenit 25 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, si dhe rekomandimet nga Sekretariati i Energjisë (Vjenë, Austri) datë 24.8.2015 dhe mbledhjes së 11-të të ECRB-së të vitit 2009 ku rekomandohet që rregullatorët kombëtarë ta miratojnë këtë rregullore, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.10.2015, mbasi shqyrtoi draftin e përgatitur dhe të rënë dakord nga (SEE CAO) dhe TSO-të aksionarë të saj, të Rregullave të Ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandeve për Europën Juglindore (SEE CAO), versioni 1.2 dhe relacionin përkatës,

Konstatoi se:

- Rregullorja është e hartuar në përputhje me kërkesat e rregullores (KE) 714/2009 të Parlamentit Evropian. Në cilësinë e vendit anëtar të ECRB-s rekomandohet që rregullatorët Kombëtarë anëtarë të saj, ta miratojnë këtë rregullore.

- Sekretariati i Energjisë (Vjenë, Austri) datë 24.8.2015 dhe mbledhja 11-të e ECRB-së mbajtur më datë 9.7.2009, rekomandon që rregullatorët Kombëtarë ta miratojnë këtë rregullore.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë rregullat e ankandit të zyrës se koordinuar të ankandeve për Evropën Juglindore SEE CAO, versioni 1.2. (bashkëlidhur në gjuhën origjinale angleze).

2. Vendimet nr. 156 datë 1.12.2014 dhe nr. 14, datë 11.2.2015, të bordit të ERE, shfuqizohen.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë personat e interesuar për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare në versionin zyrtar në gjuhen angleze dhe në faqen e ERE-s në gjuhën shqipe dhe angleze.

KRYETARI I ERE-S
Petrit Ahmeti